



RREGULLORE PER PROVIMIN E RILICENCIMIT TE PSIKOLOGEVE

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN E PROVIMIT TË RILICENCIMIT

Kjo rregullore nxirret në përputhje me Ligjin nr.40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë, Statutin e Urdhrit të Psikologut si dhe Rregulloren e Edukimit në Vazhdim.

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe mënyrën e organizimit të provimit të rilicencimit për psikologët që nuk kanë përmbushur kreditet, sipas kërkesave të Rregullores së Edukimit në Vazhdim.

Neni 2

Përkufizime

Në kuptim të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Provimi i rilicencimit" është kontrolli i njohurive dhe aftësive të profesionistit që ushtron profesionin e tij si psikolog, i cili nuk ka plotësuar kërkesat e Rregullores së Edukimit në Vazhdim.
2. "Pjesëmarrës në provim" quhet profesionisti i cili nuk ka përmbushur kërkesat e Rregullores së Edukimit në Vazhdim.

Neni 3

Provimi i rilicencimit

1. Provimi i rilicencimit kryhet për të vlerësuar nivelin e njohurive dhe kompetencave të profesionistëve që nuk janë angazhuar plotësisht në edukimin e tyre në vazhdim gjatë periudhës 5 vjeçarë të vlefshmërisë së Lejes së Ushtrimit të Profesionit.
2. Përmbajtja e provimit hartohet nga Komisioni i Provimit, në përputhje me fushën e veprimtarisë profesionale dhe me zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushë. Provimi i rilicencimit do të zhvillohet i ndarë sipas fushave të kompetencës.
3. Pas përfundimit me sukses të provimit, pjesëmarrësit në provim i jepet dëshmia përkatëse nga Komisioni i Provimit dhe më pas Leja e Ushtrimit të Profesionit nga Komisioni i Licencimit.



Neni 4

Autoriteti përgjegjës

1. Urdhri i Psikologut (UP) është përgjegjës për përzgjedhjen dhe ngritjen e Komisionit të Provimit.
2. Komisioni i Provimit është përgjegjës për hartimin e programit të provimit të rilicencimit dhe korigjimin e përgjigjeve brenda afateve të përcaktuara në këtë rregullore.
3. Sekretari i Përgjithshëm i Urdhrit të Psikologut është përgjegjës për monitorimin e procesit të zhvillimit të provimit.

Neni 5

Lista e pjesëmarrësve në provim

1. KEVP harton listën e profesionistëve që nuk kanë përmbushur detyrimet e programit të rilicencimit dhe Sekretaria e bën atë publike.
2. Të gjithë profesionistët e listës së cituar në pikën I të këtij neni duhet të regjistrohen pranë U.P. për të kryer provimin. U.P. mban përgjegjësi për saktësinë e hartimit të listës së pjesëmarrësve në provim.

Neni 6

Komisioni i provimit të rilicencimit

1. Presidenti i UP, miraton Komisionin e Provimit të Rilicencimit.
2. Komisioni i Komisionin e Provimit të Rilicencimit përbëhet nga 10 anëtarë, nga dy përfaqësues të fushave të ndryshme të kompetencës:
 - a) Shëndet Mendor.
 - b) Psikologji Edukimi.
 - c) Psikologji Pune dhe Organizacionel.
 - d) Psikologji Juridike
 - e) Psikologji Sociale dhe e Komunitetit.

Neni 7

Periudha e zhvillimit të provimit

1. Datat e provimit caktohen nga Urdhri i Psikologut, në dy periudha të ndryshme të vitit, duke marrë në konsideratë periudhat e përfundimit të vlefshmërisë së licencave si dhe kërkesat e aplikantëve për provim.



Neni 8

Programi i provimit

2. Programi orientues i provimit të rilicencimit shpallet përpara datës provimit në faqen zyrtare të Urdhrit të Psikologut.

Neni 9

Zhvillimi provimit

1. Fondi i pyetjeve të provimit me përgjigjet përkatëse (me shkrim) hartohen nga Komisioni i Provimit të Rilicencimit në nivele të ndryshme vështirësie
2. Pyetjet e provimit përzgjidhen në mënyrë rastësore nga fondi i pyetjeve të hartuara nga Komisioni i Provimit të Rilicencimit.
3. Hartuesit kanë përgjegjësi për saktësinë e pyetjeve të hartuara nga ana e tyre dhe për zbatimin e Ligjit nr. 9380, datë 28.04.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", i ndryshuar.

Neni 10

Pagesat për Provimin

1. Pagesat për Provimin propozohen nga Zyra e Financës së U.P. dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar.

Neni 11

Detyrat e Komisionit të Provimit

1. Komisioni i Provimit është përgjegjës për hartimin e pyetjeve të provimit me zhvillim, alternativa dhe raste studimi, me përmbajtje brenda programit orientues për specialitetin përkatës dhe në përputhje me zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në këtë fushë. Teza ka 100 pikë në total.
2. Ditën e provimit, para fillimit të provimit, Administrata e U.P. do të sistemojë në sallën e provimit të gjithë profesionistët e paraqitur në provim. Vendorsja në sallë organizohet në mënyrë që profesionistët të kenë sa më pak mundësi komunikimi midis tyre.
3. Çdo profesionisti i verifikohet identiteti me dokumentin personal të identifikimit që ka me vete. Çdo profesionist pjesëmarrës në provim duhet të jetë i pajisur me mjetet didaktike.



4. Provimi do të zgjasë maksimumi 2 orë.
5. Nëse profesionisti e përfundon provimin para përfundimit të kohëzgjatjes maksimale ai dorëzon fletën e provimit dhe largohet. Administrata e U.P. para marrjes në dorëzim verifikon që në fletën e provimit të jetë vendosur emri (emër, atësi, mbiemër) i profesionistit.
6. Pas përfundimit të kohëzgjatjes maksimale të provimit mbledhen provimet e profesionistëve që nuk e kanë dorëzuar ende fletën e provimit, duke verifikuar në çdo rast vendosjen e emrit (emër, atësi, mbiemër) në fletën e provimit.
7. Komisioni i Provimit korigjon provimet brenda 7 ditëve pune dhe plotëson procesverbalin e provimit me rezultatet, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Modeli i procesverbalit të provimit i bashkëngjitet kësaj rregulloreje.

Neni 12

Regjistrimi dhe pranimi në provim

1. Profesionisti i cili njoftohet për detyrimin për të kryer provimin duhet të bëjë një kërkesë me shkrim për t'u regjistruar për provim.
2. Kërkesës për regjistrim duhet t'i bashkëngjiten dokumentet e mëposhtëm:
 - a) fotokopje e kartës së identitetit,
 - b) fotokopje e lejes së ushtrimit të profesionit,
 - c) fatura e pageses për provimin e certifikimit.
3. Urdhri Psikologut publikon listën e pjesëmarrësve në provimin në faqen e tij zyrtare dhe datat e zhvillimit të provimit.

Neni 13

Mënyra e zhvillimit dhe administrimit të provimit

1. Provimi i certifikimit me shkrim nga Komisioni i Provimit do të zhvillohet në datat e përcaktuara sipas nenit 7 të kësaj rregulloreje në mjediset e përcaktuara dhe të publikuara më parë.
2. Ditën e zhvillimit të provimit, pjesëmarrësit në provim duhet të kenë parasysh rregullat e mëposhtme:
 - a) Të jenë të pajisur me dokument identiteti (kartë identiteti ose pasaportë), ~~si dhe me një fotokopje të saj;~~
 - b) ndalohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave celularë dhe mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të provimit, pasi kjo vlerësohet si kriter skualifikimi;



- c) ndalohet komunikimi gjatë zhvillimit të provimit.
- 3. Salla e provimit mbikqyret nga Administrata e U.P.

Neni 14

Modalitetet e zhvillimit të provimit të rilicencimit

1. Nëse një profesionist nuk paraqitet në provim ose tërhiqet përpara fillimit të tij, atëhere provimi nuk vlerësohet si i kryer.
2. Tërheqja nga provimi nuk mund të kryhet pas hyrjes në sallën e provimit.
3. Profesionisti që del nga salla e provimit, nuk do të rihyjë në sallën e provimit.

Neni 15

Vlerësimi i provimit

1. Provimi cilësohet i kryer me sukses nëse profesionisti ka marrë të paktën 50% të pikëve maksimale.
2. Komisioni i Provimit ka të drejtë që në rast se evidenton shkelje të rënda të rregullave të provimit, të mos kualifikojë pjesëmarrësit që thyejnë rregullat.
3. Komisioni i Provimit mban procesverbal ku evidenton shkeljet e konstatuara.

Neni 16

Shpallja e rezultateve

1. Rezultatet e provimit i bëhen të ditur çdo pjesëmarrësi individualisht.
2. Përdorimi i rezultateve të provimit nga autoritetet përgjegjëse bëhet në përputhje dhe zbatim të dispozitave të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Neni 17

Përsëritja e provimit

Profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të përsërisë provimin në një kohe të dytë jo më shumë se 5 herë.



Neni 18

E drejta e ankimit

1. Profesionisti pjesëmarrës në provim ka të drejtë të verifikojë përgjigjet e dhëna dhe të kontestojë rezultatin me një ankesë me shkrim brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultatit.
2. Komisioni i Provimit kthen përgjigje të argumentuar brenda 10 ditëve nga marrja në dijeni për ankesën.

Neni 20

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit në Këshillin Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.



PROCESVERBAL I PROVIMIT TË CERTIFIKIMIT TË ZHVILLUAR NGA KOMISIONI I PROVIMIT TË RILICENCIMIT

Procesverbal i rezultateve të provimit të rilicencimit të mbajtur më datë.....me Komision Provimi të përbërë nga :

1. _____ (anëtar),
2. _____ (anëtar),
3. _____ (anëtar),
4. _____ (anëtar),
5. _____ (anëtar)

Nr	(Emri, Atësia, Mbiemri)	Nr.Licence	Fusha kompetencës	ePikët Provimit	eRezultati (Kalon/ngel)
1.					
2.					
....					

(Anëtar) (Anëtar) (Anëtar)

(Anëtar) (Anëtar)

